



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të,  
Prishtinë, Kosovë

Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

PSh. Nr. 14/22

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 (i amandamentuar), në përbërje nga, Vedat Poterqoi-Kryetar Isa Hasani Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Anëtar, pas shqyrtimit të kërkesës për diskualifikim të ushtruar nga Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), (Nr. Protokolli 14/22), ushtruar ndaj Operatorit Ekonomik (OE) N.T "ShpatTurs", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme" me numër të prokurimit: 632-21-6314-2-1-1, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës dhe nenit 32 të Rregullores së Punës së OSHP 01/2020, e amandamentuar 09. 08. 2023, me 01.12.2023, mori:

### V E N D I M

1. Refuzohet, si e pabazuar kërkesa e Komunës së Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, e datës 12.01.2022, nr. protokolli 14/22, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE N.T "ShpatTurs" me numër të biznesit: 810222810, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme" me numër të prokurimit: 632-21-6314-2-1-1.

2. Udhëzohet AK (me shënimë si më sipër) që ta konfiskoj shumën e mjeteve të deponuara nga OE "N.T "ShpatTurs" në emër të sigurimit të ofertës, siç parashihet me nenin 57, paragrafi 1.1, të LPP.

### A r s y e t i m

Me 12.01.2022, Komuna e Gjakovës në cilësinë e AK, ka dorëzuar në OSHP kërkesë për aplikim të masave sipas nenit 99 pika 2 të LPP, ndaj Operatorit ekonomik N.T "Shpat Turs" me seli në Gjakovë me numër unik të regjistrimit 810222810, nën pohimin se ekziston dyshimi për "paraqitjen e të dhënavë të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga ky operatorë ekonomik ashtu sikurse parashihet me nenin 99 par 2 të LPP.

Komuna e Gjakovës në cilësinë e AK si arsyé pér marrjen e masave në pajtim me nenin 99.2 të LPP-së në kérkesën e lartcekur ka specifikuar se Operatori Ekonomik N.T “Shpat Turs” me seli në Gjakovë, kanë marr pjesë në aktivitetin e prokurimit: “Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme” me numër të prokurimit: 632-21-6314-2-1-1. AK-Komuna Gjakovë ndaj Operatorit ekonomik ka kérkuar brenda afatit ligjor vërtetimin nga ATK se nuk ka bortxhe të tatimeve dhe vërtetimin nga Gjykata kompetente se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor. Por, që Operatori ekonomik N.T “Shpat Turs” me seli në Gjakovë, nuk i ka dorëzuar brenda afatit ligjor. AK-Komuna Gjakovës në përputhje me nenin 26.8 të RRUOPP ka vazhduar me tenderuesin e listuar në vendin e dytë dhe përmes kësaj kérkese pranë OSHP-së kérkon diskualifikimin e Operatorit Ekonomik. Komuna Gjakovës kérkon nga OSHP zbatimin e nenit 99.2 të LPP-së se Operatori Ekonomik ka paraqitur të dhëna të rreme me rastin e dorëzimit të ofertës me datë 15.0.2021, kur së bashku me ofertë ka dorëzuar Deklaratën nën Betim në të cilën OE deklaron se i përbush kushtet e përshtatshmërisë, respektivisht nenin 65 të LPP-së. Andaj duke u nisur nga këto prova AK-Komuna Gjakovës kérkon nga OSHP që konform irregullave ligjore të merren masa ndaj këtij Operatori Ekonomik.

Organ Shqyrtyes i Prokurimit me datën 13.01.2022 e ka njofuar N.T “Shpat Turs”, me kérkesën e AK-së “Komuna Gjakovë” pér diskualifikim. Me datë 18.01.2022 N.T “Shpat Turs” ka kthyer përgjigje pranë OSHP-së duke theksuar: “*Ne si firmë transportuese jemi të indinjuar dhe të dëmtuar jashtëzakonisht shumë në biznesin tonë në lidhje me vendimin e ashpër dhe jo fer nga ana e juaj. Pasojat tuaja të veprimit firmës sonë do ti kushtojnë me vlera dhjetëra here më të mëdha se sa vlera e lotit ku kishim konkurruar, pasiqë ju tani kérkon të na ndëshkon me diskualifikim (1) një vjeçar në pjesëmarrje të prokurimit publik duke na cilësuar si ndërmarrje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar si operatorë ekonomik e që në fakt nuk keni pasur asnjë lloj dokumenti nga ana jonë si të tillë. Anët teknike të neglizhencës tonë ndaj mos shqimit të emalit tuaj me dt.9.12.22 kanë mundur te tekalohen lehtas kur ju keni telefonuar tek ne, dhe në atë telefonatë shumë lehtë dhe me dy fjalë keni mundur të na tregoni se duhet sjellë shtesë vërtetimin e ATK-së dhe vërtetimin e Gjykatës ekonomike, të cilat veç i kishim të përgatitura dhe qëndronin në sirtarët e firmës tonë. ( Këtë gjë e keni bërë me operatorët tjera prandaj edhe kam të drejtë ta marr edhe si tendencioz ndaj meje, ndoshta edhe pér interesat tuaja me njërin nga ta).*

*Duke mos qenë hiq mirënjoës ndaj juve kérkoj që të më hiqet Kérkesa pér zbatim të nenit 99.2 në mënyrë që një biznes i shëndoshë dhe me reputacion të mos jetë peng njëvjeçar i punës së transportit edhe në nivel më të lartë se aj Komunal se kjo me kushton shumë materialisht. Ju duhet të ndihmoni biznesin e Gjakovës të cilin po e dëmtoni shumë si në këtë rast, ju duhet të dilni nga diapazoni lokal dhe nga kthetrat e interesit me individët dhe firmat tanimë të njohura që kryejnë transport me buxhetin e Komunës.”*

-Seanca dëgjimore-

Paneli shqyrtyes pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha provave të lëndës, konstatoj se seanca dëgjimore të mbahet pa prezencën e palëve konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020.

**Paneli Shqyrtues** mori në shikim të gjitha shkresat e kësaj lënde të cilat i analizoi në kontekstin e veprimeve të ndërmarrja nga të dyja palët, nga kuadri aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër dhe konstatoi se kërkesa e AK në rastin konkret, në kuptim të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nuk mund të aprovohet ngase sa i përket arsyes së dhënë për diskualifikim të OE nga AK, vlerëson se nuk janë përbushur kushtet sipas nenit 99. 2 për diskualifikim të OE, sepse ky aktivitet i prokurimit është anuluar në tërësi don të thot nuk kemi dëmtim të buxhetit, po ashtu vlera e parashikuar e kontratës ka qenë vlerë e vogël jo ndonjë impakt në jetën e qytetarëve kurse OE ka dekluaruar se i posedon dokumentacionin e kërkuar për kërkeshat e përshtatshmërisë, por i nejti ka pasur probleme teknike administrative ne administrim të emalit zyrtar të tij/saj duke e humbur kesojoji afatin per të ju përgjigjur kërkeshës se AK-se.

Paneli shqyrtues është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK ka ofruar prova ashtu siç potencohet në paragrafin 2, të nenit 99 të këtij Ligji, sipas të cilit, cituar: “Në bazë të një kërkese me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënavë të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare”.

Paneli konsideron se AK nuk ka ofruar në ketë rast ndonjë dëshmi apo provë për paraqitje të dokumenteve te rreme apo të falsifikuara nga ana e OE “Shpat Tours”, mirëpo përpos tjerave, theksuar si më sipër Paneli sipas gjykimit të tij të pavarrur pas administritimit te te gjitha provave relevante ka konsideruar se edhe pse OE nuk i ështët përgjigjur AK me kohe si rezultat i kësaj nuk është nënshkruar kontrata, AK me qëllim të vedijësimit të secilit OE ka të drejtë të bëjë konfiskimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës.

Paneli shqyrtues, duke ju referuar të lartcekurave si dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 99.2 te LPP, vendosi si në diapositiv të këtij vendimi.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari/ja e Panelit



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, kurse pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet me kërkeshëpadi Gjykatës Kompetente për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.